



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 24, datë 04.03.2019

PËR

**MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE, NDAJ PUNONJËSES PRANË SHOQËRISË
SË SIGURIMEVE “EUROSIG” SH.A., NË SHKOZET, DURRËS, ZJ. RUDINA SKONJA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 21) të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 199, pikës 6) dhe 7), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, u depozitua një ankesë në datën 29.01.2019, ku pretendohet për shitje të një police TPL me numër serie 190060997, nga një person në pikën e shitjes së shoqërisë “Insig” sh.a., në Fushë Prezë, ndërkohë që policia mbante logon e shoqërisë “Eurosig” sh.a. dhe emrin e agjentes zj. Rudina Skonja dhe jo të asaj që e kishte lëshuar, si dhe faktin që ajo policë nuk figuronte e shitur në sistem në ditën që ishte lëshuar.

Nga i shqyrtimi i materialeve të depozituara, i policave të shitura nga kodi i saj, që nga data 28.01.2019 deri më datë 30.01.2019, si dhe dokumentin përkatës për furnizimin me policë nga shoqëria, rezultonte edhe policë TPL me nr. serie 190060997 si e shitur prej saj.

- Kopja e policës me nr. serie 190060997, që i ishte dhënë personit të siguruar, nuk përputhej me të dhënat e kopjes së asaj serie police që disponohej nga punonjësja e shitjes zj. Rudina Skonja, gjë që bie në kundërshtim të plotë me kërkesat e pikës 2 të nenit 38, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.
- Zj. Rudina Skonja i ka dhënë z. Lek Frroku, i cili ushtronte aktivitetin e shitjes së policave kufitare në Portin e Durrësit, për llogari të shoqërisë “Eurosig” sh.a., seritë nga

190060991 deri 190060998 (8 copë). Ndërkohë z. Frroku rezulton që nuk është i licencuar/miratuar nga Autoriteti.

Punonjësja ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 198, pika 4, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, nenit 38, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, si dhe me nenin 5 të Rregullores nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Bazuar në pikat 6, 7 të nenit 199, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, për punonjësen e shoqërisë “Eurosig” sh.a., zj. Rudina Skonja, të pezullohet ushtrimi i veprimtarisë për shitjen e policave të sigurimit për një periudhë prej 6-muaj.**
- 2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI